



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.129, datë 02.06.2022

PËR  
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe në relacionin e përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zonja Afërdita Ndoi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, të caktohet të ushtrojë përkohësisht funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër.
2. Zonja Afërdita Ndoi, do të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër nga data 07.06.2022 deri më 11.06.2022.
3. Të njoftohen për këtë vendim zonja Afërdita Ndoi, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 02.06.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR  
Alfred Balla

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Elaida Goxhi

ANËTAR  
Bujar Sheshi

ANËTAR  
Esmeralda Keshi

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj

ANËTAR  
Nurihan Seiti

ANËTAR  
Ludovik Dodaj



ANËTAR  
Zeqir Hoda

ANËTAR  
Mirela Bogdani